



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës , Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Nr. 02/L-57, Ligjin Nr. 04/ L-106 për Teatrot, Statutin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.15/2018, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhezimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

Titulli i punës: Dramaturg

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Vendi: Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore

Paga: Paga Fikse- 656.0 €

Numri i referencës: RN00009705

Kodi: RPC0003432

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Dramatizimi i veprave në varësi të kërkesave të regjisorit dhe drejtuesve të Teatrit Kombëtar të Kosovës-TKK;
2. Shkrimi i komunikatave dhe lajmeve informative për punën e TKK;
3. Mirëmbajtje e informatave dhe lajmeve në ueb faqen e TKK-së, përpilimi dhe shkrimi i programeve të shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Kosovës;
4. Përpunimi i teksteve arkivore dhe monografive të punës së Teatrit , lektorimi i shkresave dhe teksteve ;
5. Punë të tjera të kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kualifikimet dhe përvoja:

1. Të ketë të mbaruar Fakultetin e Arteve, Dega e Dramaturgjisë.
2. Të ketë së paku tri (3) vite përvojë punë në këtë profesion.
3. Të ketë njohuri mbi dramaturgjinë botërore dhe kombëtare;
4. Të ketë aftësi organizative dhe drejtuese.
5. Ta njeh mire profesionin e dramaturgut.
6. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Titulli i punës: Mjeshtër Ndriçimi

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Vendi: Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore

Paga: Paga Fikse-375.0 €

Numri i referencës: RN00009705

Kodi: RPC0003432

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Udhëheq sektorin e elektrikes në Teatrin Kombëtar të Kosovës (TKK) ;
2. Bashkëpunon me regjisorët, rreth disejnit të ndriçimit të shfaqjes;
3. Koordinon orarin dhe punët e elektricistëve dhe ndriçuesve në TKK;
4. Kryen edhe punë të tjera elektrike, në varësi të kërkesave të udhëheqësit.

Kualifikimet dhe përvoja:

1. Shkollimi i mesëm;
2. Përvojë pune në Teatër;
3. Njohje e punëve elektrike;
4. Njohje e disejnit të dritave në skenë;
5. Gjuha Angleze e preferuar;
6. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Titulli i punës: Rrobaqepës

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Vendi: Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore

Paga: Paga Fikse -375.0 €

Numri i referencës: RN00009705

Kodi: RPC0003432

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bënë prerjen dhe qepjen e kostumeve sipas kërkesave të kostumografit, apo regjisorit e shfaqjes;
2. Bënë prerjen dhe qepjen e kostumeve dhe uniformave të stafit të TKK sipas kërkesave të menaxhmentit;
3. Udhëheq me sektorin e rrobaqepësisë në Tetarin Kombëtar të Kosovës(TKK).

Kualifikimet dhe përvoja:

1. Shkollimi i mesëm;
2. Përvojë paraprake në rrobaqepësi;
3. Njohja e gjuhës Angleze e preferueshme;
4. Shkathtësi të mira organizative dhe komunikuese;
5. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Titulli i punës: Udhëheqës tekniko- artistik

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Vendi: Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore

Paga: Paga Fikse - 439.0 €

Numri i referencës: RN00009705

Kodi: RPC0003432

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Udhëheq dhe mbikëqyrë të gjithë stafin tekniko artistik;
2. Bashkëpunon me regjisorët dhe skenografët e shfaqjeve, për realizimin e punëve të skenografisë dhe skenës;
3. Kontrollon dhe mbanë përgjegjësi , për strukturën e skenografisë dhe elementeve të tjera skenike.
4. Në bashkëpunim me regjisorët dhe skenografët e shfaqjeve, bëjnë listën e nevojave .

Kualifikimet dhe përvoja:

1. Shkollimi i Lartë për: Skenografi, Arkitekturë ose Ndërtimtari;
2. Shkathtësi komunikimi;
3. I/E gatshëm për punë, në presion;
4. Gjuha Angleze e domosdoshme
5. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:

- 1.1 të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin; Ligji për Zyrtarët Publik, Nr.06/L-114, Ligji për Institucionet e Kulturës, Nr. 02/L-57, Ligji Nr. 04/ L-106 për Teatrot, Statutin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Rregulloren (QRK)Nr.15/2018, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik .

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, për pozitat e shpallura më lartë, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe me gojë sipas nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është pa afat të caktuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit në web faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 09.08.2022 deri me dt. 07.09.2022, ndërsa data e aplikimit është , nga data 08.09.2022 deri me datën 22.09.2022.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921(apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).